REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 725/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 725/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE N.T.P. "Miri" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", me nr. të prokurimit: KOSTT-20-3500-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KOSTT sh.a., më datë: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa operatorit ekonomik: N.T.P "Miri" SH.P.K- Prishtinë , kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", me nr. të prokurimit: KOSTT-20-3500-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KOSTT sh.a.,

II.VËRTETOHET, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", me nr. të prokurimit: KOSTT-20-3500-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KOSTT sh.a.,

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik N.T.P "Miri" SH.P.K- Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i depozitës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE N.T.P. "Miri" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 28.09.2020 me nr. 725/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", me nr. të prokurimit: KOSTT-20-3500-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KOSTT sh.a., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56, 59 dhe nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 14.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Paraprakisht, eksperti vlerëson që konform nenit 1 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga Autoriteti Kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Sa i përket pretendimit ankimorë të OE ankues ku thuhet që Autoriteti Kontraktues pa të drejtë i ka eliminuar si OE të papërgjegjshëm edhe pas përgjigje ndaj Kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shkresave zyrtare gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar, duke arsyetuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues është dashur që Konform nenit 12 të RRUOPP për parashikimin e vlerës dhe klasifikimin e kontratës ku thuhet që "vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike", të përcaktojë vlerë të arsyeshme për kontratën e parashikuar. Një vlerë e tillë për këtë aktivitet të prokurimit rezulton të jetë 38,000 EUR, me kohëzgjatje të kontratës publike kornizë prej 36 muajsh. Marrë parasysh ofertën e OE ankues brenda vlerës së parashikuar së kontratës publike kornizë përkundër sasisë indikative dhe mospërputhjes së lejuar me plus/minus tridhjetë përqind (30%), interpretimi i ofertave pjesëmarrëse, gjegjësisht çmimit të tyre pas kategorizimit si jo-normalisht i ulët nga Autoriteti Kontraktues jo-domosdoshmërisht përkon me dispozitat ligjore të shënuara tek Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Konform nenit 4 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, gjegjësisht "Procedura e shqyrtimit (inter partes)", Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të merr në konsideratë zgjidhjet teknike të ofruara, ekonominë e procesit të shërbimeve të ofruara dhe çfarëdo kushte të tjera të favorshme që janë vendosur në dispozicion nga OE për kryerjen e shërbimeve. Si rezultat, përcaktimi i çmimit të tenderit si ekonomik dhe përmbajtësor me çmimet e tregut është nën diskrecionin e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti vlerëson që përgjigja e OE ankues ndaj Letrës Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët dërguar nga AK përmban informata të cilat i adresohen pyetjeve të AK-së, ku në rast të mos-detajizimit të mirëfilltë të pyetjeve rekomandohet që AK të kërkojë sqarime shtesë konform dispozitave ligjore në fuqi. Po ashtu, bazuar në nenin 30.4 të RRUOPP të Sigurisë së Ekzekutimit të Tenderit, Autoriteti Kontraktues pasi që të jetë përputhur me nenin 61 te LPP-së, ka mjaft arsye për të besuar se operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit t'a rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që vendimi për anulim të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN" me nr. të prokurimit: "KOSTT-20-3500-2-2-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: OPER. SISTEMI,TRANS.DHE TREGU- KOSTT SH.A., të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues me datë: 15.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues duke sqaruar:
Deklarojmë se pajtohemi me mendimin dhe raportin e Ekspertit shqyrtues dhe të njëjtat pretendimet tona i kemi dhënë në ankesë, andaj për shkak të parregullsive dhe shkeljeve të cekura nëpërmjet ankesës tonë të dorëzuar, për të cilat është pajtuar edhe eksperti shqyrtues, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, t'a aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit për tenderin "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit DEFENDER dhe NISSAN", me nr. të prokurimit: KOSTT-20-3500-2-2-1, numri brendshëm: KOSTT5323/1/2-20-42-221 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa eshët parashtruar kundër njoftimit për anulim te aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues ku thuhet që Autoriteti Kontraktues pa të drejtë i ka eliminuar si OE të papërgjegjshëm edhe pas ka dhen përgjigje ndaj Kërkesës për informata mbi

tenderët jo-normalisht të ulët dhe se AK-ja, kryesisht nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së .

Paneli shqyrtues, sqaron se OE ankues është njoftuar nga AK-ja, me letrën standarde te tenderuesit te eliminuar me arsyetimin se: Edhe pse pas kërkesës për sqarime të çmimeve jo normalisht të ulëta, Ju si OE nuk keni arritur të na bindeni neve si AK KOSTT, prandaj konform Nenit 61.1 dhe 61.4 të LPP-së dhe oferta e Juaj refuzohet si Jo-normalisht e ulët.

Paneli shqyrtues konstaton se AK-ja, gjate vlerësimit te ofertave ka vërejtur se OE ankues ka ofruar çmime Jo/Normalisht te ulëta dhe njëherit ka kërkuar sqarim te pozicioneve nga OE ankues.
Konform kërkesës së AK-së, me datën: 09.09.2020 OE ankues ka kthyer përgjigje i cili i ka shpjeguar autoritetit kontraktues pozicionet për te cilat autoriteti kontraktues ka pasur dyshime.
Pas pranimit te përgjigjes autoriteti kontraktues Operator Sistemi, Trans dhe Tregu, ne përputhje me paragrafin 4 te nenit 61 te LPP-së, e ka eliminuar duke i konsideruar se arsyetimi i OE ankues nuk ka qenë bindës për autoritetin kontraktues.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh që AK ka zbatuar procedurat "Inter partes" konform LPP-së dhe Rregullores për çmime jo normalisht te ultë si dhe RRUOPP konstatojmë se vlerësimi i çmimeve sipas dispozitave te nenit 61 të LPP-së, është në te drejtën e autoritetit kontraktues, andaj pretendimi i OE ankues për mos respektim te nenit 61 të LPP-së, është i pa qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se ka pasur pozicione te ndërtimit te pjesëve te cilat nuk u përkasin automjeteve te precizuara ne dosje.
Paneli shqyrtues konstaton se në pajtim me nenin 108/A të LPP-së dhe piken (a) te paragrafit 1 te nenit 4 te ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** , për kërkesat e dosjes së tenderit te vendosura në kundërshtim me LPP-në, si dhe përgatitjen e dosjes së tenderit nga ana e AK-së në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, operatoreve ekonomik ju është lejuar kërkesa për rishqyrtim - ankesa në fazën e njoftimit për kontrate dhe atë pesë (5) ditë para hapjes së ofertave në AK me pas edhe në OSHP.
Nëse operatoret ekonomik nuk parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim – ankesë në ketë fazë lidhur me përgatitjen e dosjes së tenderit, kriteret dhe specifikacionet e kërkuara në atë dosje nga ana e AK-së, kjo nënkupton se operatoret ekonomik e kanë pasur të qartë dosjen e tenderit, kriteret dhe specifikacionet teknike të kërkuara për atë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 dhe nenin 61 te LPP-se të LPP-së dhe njëkohësisht AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në pajtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44 të RRUOPP.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KOSTT sh.a.

1x1 OE - N.T.P. "Miri" – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.